



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

TENDENCAT PËR RRËNIMIN E MULTIETNICITETIT

LARGIMET MASIVE TË PJESËTARËVE SERB
TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS DHE
ROLI I SERBISË



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

TENDENCAT PËR RRËNIMIN E MULTIETNICITETIT

LARGIMET MASIVE TË PJESËTARËVE SERB
TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS DHE
ROLI I SERBISË

Botues: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Autor: Shpat Balaj dhe Taulant Boshnjaku

Redaktimi i Brendshëm: Donika Marku dhe Donika Emini

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura mbron të drejtat dhe pronën intelektuale.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen me shkrim të botuesit.

Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i asnjë materiali të botuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim të QKSS-së. Ju lutemi të kontaktoni: info@qkss.org ose +383 38 221 420

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Presionet ndaj pjesëtarëve serb të FSK-së dhe largimi masiv i tyre përbën një ndër ndërhyrjet më brutale të Serbisë në institucionet shtetërore të Kosovës. Këto ndërhyrje kanë për qëllim rrënimin e multietnicitetit dhe të arriturave të deritanishme në FSK. Sipas rezultateve të hulumtimit tonë, del se plani për largimin e mbi 60 pjesëtarëve serb është bërë si pjesë e një operacioni të mirë-planifikuar psikologjiko-ushtarak (psyops), i orkestruar nga elemente të inteligjencës ushtarake nga Beogradi dhe Vranja. Për arritjen e këtyre qëllimeve destruktive janë përdorur mjete të shantazheve ndaj këtyre pjesëtarëve duke kërcënuar me heqjen e pensioneve për pjesëtarët e familjes së ngushtë dhe të gjerë, bllokimin e lëvizjes në Serbi, etiketimin si “tradhtarë” dhe “jeniçerë” e kështu me radhë.

Rrjedhimisht, këto veprime kanë larguar çdo dilemë se partitë politike serbe do t’i përkrahin ndonjëherë ndryshimet kushtetuese për transformimin e FSK-së. Opsioni i vetëm i mbetur është tranzicioni i FSK-së në një periudhë kalimtare përmes ndryshimit të ligjit.

Gjetjet kyçe:

- Serbia ka kryer agresion ndaj institucionit të FSK-së duke ndikuar me dhunë në largimin e pothuajse 50% të pjesëtarëve serb të FSK-së, numër ky i cili rrezikon të rritet muajve në vijim nëse nuk ndërmerren masat e duhura nga institucionet Kosovare dhe partneret ndërkombëtar;
- Si mjet presioni janë përdorur kërcënimet për largimin nga paga/pensioni i familjarëve të ngushtë dhe të gjerë të këtyre pjesëtarëve dhe ndalim-hyrja në Serbi. Janë bërë trysni psikologjike dhe janë përdorur metoda speciale ku këtyre pjesëtarëve i është transmetuar se kinse së shpejti do të ketë luftës në mes Serbisë dhe Kosovës dhe se ata ‘do të përfundojnë duke luftuar kundër vëllezërve të tyre serb të Armatës Serbe’;
- Për të arritur rezultate, është përgatitur një operacion special psikologjiko-ushtarak i ndihmuar nga krerët e politikës serbe. Rol të drejtpërdrejt në këtë operacion ka pasur Presidenti Vuçiq, Ministri i Mbrojtjes Vulin, Kryetari i Komisionit Parlamentar për Kosovë Drecur si dhe eksponentët të Listës Serbe në territorin e Kosovës;
- Operacioni ka pasur kryesisht për target pjesëtarët serb në rajonin e Anamoravës, respektivisht pjesëtarët e Batalionit të I-rë të Brigadës së Reagimit të Shpejtë (BRSH) në Gjilan. Këta janë pjesëtarët më të hershëm të FSK-së nga komuniteti pakicë serb dhe kanë treguar rezultate të mira në veprimtarinë e tyre;
- Dëmi i shkaktuar nga ky operacion nuk është vetëm politik por edhe institucional. Fjala është për minimin e investimeve të mëdha që janë bërë në këta pjesëtarë siç janë në shkollim, ngritje në karrierë, paga etj,

HYRJE

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) është bërë temë e debateve publike për shkak të përpjekjeve për ndryshimin e mandatit të saj. Në opinionin publik është krijuar huti për shkak se ende nuk është e qartë nëse ato debate ishin vetëm llogaritje politike, apo realisht institucionet e Kosovës në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë po marrin hapa konkret drejt transformimit të saj. Për të kontribuar në këtë situatë të ngatërruar janë edhe deklaratat dhe interpretimet kundërtë të aktorëve vendor dhe ndërkombëtarë mbi këtë çështje dhe heshtja e këtij debati për një periudhë të shkurtër. Në anën tjetër, të zhytur më thellë në këtë huti siç duket janë komuniteti serb në Kosovë. Të ndodhur në mes dy taborëve me qëndrime të kundërta, komuniteti serb në Kosovë po vazhdon të ushqehet me pasiguri. Duke qenë nën presion të jashtëm nga Serbia në njërin anë dhe të varur nga përfaqësuesit e tyre në parlamentin e Kosovës, Lista Serbe, të cilët aktivitetin e kanë të dirigjuar nga Beogradi, komuniteti serb i integruar në institucionet e Kosovës gradualisht po detyrohet të bëjë hapa mbrapa në karrierën dhe pozitën e tyre në shoqëri.

Mungesa e besimit të këtij komuniteti karshi FSK-së, mospërkrahja e ndryshimit të mandatit të kësaj force si dhe kërcënimet e vazhdueshme dhe sulmet direkte ndaj pjesëtarëve Serb të FSK-së, kanë shtyrë që në vitin 2018 mbi 60 pjesëtar të këtij komunitetit të largohen nga FSK. Kjo valë largimesh ka shkaktuar një debat të gjerë në Kosovë dhe Serbi, duke arritur të ketë implikime negative dhe duke rrezikuar procesin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve mes këtyre dy vendeve. Sulmet dhe kërcënimet ndaj pjesëtarëve serb të FSK-së, të përkrahura nga Qeveria e Serbisë, kanë vënë në sipërfaqe mungesën e vullnetit e kësaj të fundit për normalizim të marrëdhënieve me Kosovën. Këto sulme janë dënuar nga Institucionet e Kosovës, por mirëpo dështimi për të parandaluar këtë fenomen ka vënë në pah mungesën e shtrirjes së autoritetit të tyre në komunat me shumicë serbe.

Andaj, ky dokument ka për qëllim të analizojë përmbledhjen e rrjedhës së ngjarjeve që shpjen deri te largimi i pjesëtarëve serb të FSK-së. Në të pasqyrohen veprimet e marra nga FSK për të siguruar integritet të qëndrueshëm të komunitetit serb në këtë institucion si dhe cilat janë objektivat për të ardhmen në këtë drejtim. Në këtë punim ofrohen disa rekomandime që synojnë t'i shërbejnë krijimit të qëndrueshmërisë në procesin e integritetit të komunitetit serb në FSK, në adresimin e të cilave është paraparë përfshirje më e gjerë e akterëve të ndryshëm.

KOMUNITETI SERB DHE FSK NË VITIN 2018

Diversiteti idealisht nuk do të duhej të ishte plan i veçantë. Në fund të ditës, diversiteti brenda FSK-së nuk duhet të shikohet nga perspektiva e drejtësisë sociale, por nga perspektiva e ngritjes së kualitetit. Qëndrimet e shtetit të Serbisë dhe përfaqësuesve të komunitetit serb në Kosovë ndaj FSK-së, kanë për synim krijimin e një ambienti të papërshtatshëm për individë nga komuniteti serb të cilët janë të gatshëm të bëhen pjesë e saj. Një gjë e tillë nënkupton tendencë të hapur nga shteti Serb për të zbehur njërin ndër vlerat tashmë të dëshmuara të FSK-së e që është krijimi i kushteve të barabarta dhe lehtësimet për gjitha komunitetet që të jenë pjesë përbërëse e kësaj force. FSK ka bërë përpjekjet të vazhdueshme për t'i dhënë kuptim asaj që përfaqëson, pra shumëllojshmërinë etnike. Për shumë vite me radhë udhëheqësit e FSK-së e kanë konsideruar integrimin e komunitetit serb si njërin ndër prioritetet dhe sfidat kryesore.¹ Në fillim të vitit 2018, FSK numëronte gjithsej 130 pjesëtarë të komunitetit Serb, të cilët përbënin numrin më të madh të komuniteteve jo-shumicë brenda FSK-së,² që nënkupton mbi 55% të numrit të përgjithshëm të komuniteteve pakicë. Niveli kaq i lartë i përfaqësimit të një komuniteti pakicë brenda FSK-së përbën padyshim një arritje e madhe, duke dëshmuar kështu vullnetin dhe gatishmërinë e këtij institucioni për ti dhënë formë parimeve mbi të cilat është themeluar.

Korniza aktuale ligjore ju garanton qasje të barabartë të gjitha etnive brenda FSK-së. Ndër të tjerash, për të siguruar gjithëpërfshirjen, FSK ka bashkëpunim me Zyrën për Çështje të Komuniteteve (ZÇK), një trup qeveritar i cili funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës. Për të lehtësuar procesin e integritit të komuniteteve pakicë, përkatësisht komunitet Serb në Kosovë, FSK për dallim nga institucionet tjera të sigurisë (p.sh. Policia e Kosovës) nuk obligon pjesëtarët e saj të kenë njohuri të dy gjuhëve zyrtare në Kosovë (Shqip dhe Serbisht) dhe të gjithë anëtarët gëzojnë të drejtën ta ushtrojnë detyrën e tyre të përditshme në gjuhën që ata e flasin.³

Në vitin 2017, Ministria e FSK-së (MFSK) ka miratuar "Planin e rekrutimit për pjesën aktive vetëm për komunitetet jo-shumicë" (Tutje në tekst: Plani), përmes të cilit ekipet mobile të FSK-së kanë pranuar aplikacionet e pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë në zonat ku ata banojnë.⁴ Rekrutimet përmes planit kanë mundur që tash e tutje secili njësit i FSK-së të pasqyrojë multi etnicitetin. Në po të njëjtin vit, në shërbim të integritit të komuniteteve jo shumicë, MFSK ka hartuar dhe miratuar edhe "Strategjinë për Integrit të Komuniteteve jo shumicë (2017-2020) në MFSK/FSK" (Tutje në tekst: Strategjia) dhe Planin e Veprimit për implementimin e saj.⁵

¹ Ceku, A. (2013). Pakicat, sfida e FSK-së. Gjetend në: <https://telegrafi.com/pakicat-sfida-e-fsk-se/>

² Shala, I. (2018). Kaq pjesëtarë serbë ka në FSK, prej tyre 40 kanë ofruar dorëheqje. Gjetend në: <http://lajmi.net/kaq-pjesetare-se-be-ka-ne-fsk-prej-tyre-40-kane-ofruar-doreheqje>

³ Emini, D. (2014) "Përfshirje apo përjashtim – Minoritetet në Sektorin e Sigurisë në Kosovën e pas-pavarësisë". Gjetend në: http://www.qkss.org/repository/docs/P%C3%ABrfshirje_apo_p%C3%ABrjashtim_Minoritetet_n%C3%AB_Sektorin_e_Siguris%C3%ABn%C3%AB_Kosov%C3%ABn_e_Pas-pavar%C3%ABsis%C3%AB_8050_00.pdf

⁴ Raporti vjetor i MFSK (2017). Gjetend në: http://www.mksf-ks.org/repository/docs/Raporti_2017_MFSK_final_fare_26122017.pdf

⁵ Po aty.

Miratimi i planit dhe strategjisë për integrimin e komuniteteve jo-shumicë dëshmon vullnetin e FSK-së për të integruar ata dhe për të zhvilluar edhe më tej procesin e integritit. Sipas strategjisë, objektivat kryesore në këtë drejtim janë: 1) Rritja deri në 10% e përfaqësimit të komuniteteve në MFSK dhe FSK; 2) Përfaqësimi i komuniteteve jo-shumicë në strukturën e gradave; dhe 3) Rritja e vizibilitetit dhe aktiviteteve të FSK-së në komunitetet jo shumicë. MFSK deri tash ka dëshmuar sukses në zbatimin e strategjisë. Gjatë vitit 2017, është ngritur në mbi 10% përfaqësimi i komuniteteve jo shumicë, duke plotësuar kështu njëzënën ndër objektivat kryesore të strategjisë brenda periudhës një vjeçare. Arritjen e këtij suksesi e mundësoi integrimi në FSK i 61 pjesëtarëve nga komuniteti serb vetëm gjatë vitit 2017.⁶ Për më tepër, zbatimi i objektivave të kësaj strategjie rezultoi në jetë prioritet strategjik i MFSK-së dhe FSK-së.

Gjatë viteve, përveç zhvillimit të kornizës ligjore dhe mekanizmave tjerë për integrimin e komunitetit Serb brenda FSK-së, FSK gjithashtu ka rritur përpjekjet për tu afruar më shumë me komunitetin në përgjithësi. FSK ka qenë pranë tyre në projekte të ndryshme, që në mënyrë të drejtpërdrejtë përfshin atë në adresimin e problemeve të përditshme me të cilat ballafaqohet komuniteti. Në mënyrë që të bëhet vlerësimi i nivelit të respektimit të drejtave të tyre, vlerësimi i sfidave potenciale dhe t'i shërbehet zhvillimit të komunikimit të qëndrueshëm, FSK në 3 vitet e fundit ka zhvilluar takime të rregullta me pjesëtarët e komuniteteve pakicë brenda FSK-së dhe me qytetarët e komunave të populluara me këto komunitete.⁷ Ndër të tjerash, FSK vetëm në vitin 2017 ka marrë pjesë në mbi 5 projekte të ndryshme në komunitet me shumicë Serbe, ku kanë dhënë kontributin e tyre në përmisimin e infrastrukturës duke qenë drejtpërdrejtë të angazhuar në rregullimin dhe ndërtimin e rrugëve të reja, renovimin e shkollave dhe aktivitete humanitare për familjet në nevojë.⁸

⁶ Po aty.

⁷ Raporti vjetor i MFSK (2015, 2016 dhe 2017)

⁸ MFSK (2017). Bashkëpunimi Civilo Ushtarak FSK 2017. Gjetendet në: http://www.mksf-ks.org/repository/docs/Revista_e_BCU_2017___Shqip.pdf

RRUGA TUTJE DHE SFIDAT E INTEGRIMIT TË KOMUNITETIT SERB NË FSK

Integrimi i komunitetit serb ka qenë një nga proceset më sfidauese për FSK-në. Me intensifikimin e dialogut në mes Kosovës dhe Serbisë dhe me përafrimin e datës për arritjen e të ashtuquajturës marrëveshje përfundimtare mes dy vendeve, gjatë 12 muajve të fundit këto sfida janë rritur. Krahas kësaj, përpjekjet e Beogradit zyrtar për të minimizuar të gjitha arritjet e deritanishme brenda këtij institucioni kanë marrë përmasa alarmante. Këto përpjekje janë duke u bërë përmes keqpërdorimit të pozitës së tanishme të komunitetit Serb në Kosovë, i cili edhe më tutje gjendet në mes të kërkesave dhe nevojës për integrim në kuadër të institucioneve të Kosovës dhe në anën tjetër vazhdon të jetë besnik ndaj shtetit Serb, duke i vendosur ata në pozicione diametralisht të kundërta. Madje, kronologjia e ngjarjeve tregon se Qeveria e Serbisë vitin e fundit është duke përdorur masa mjaft agresive si kanosjet fizike e shantazhet e ndryshme për të detyruar pjesëtarët Serb të kësaj force ta braktisin atë.

Në fund të vitit 2017, shtëpitë e dy pjesëtarëve Serb të FSK-së në Zubin Potok u sulmuan me mjete shpërthyesë.⁹ Ky sulm sipas gjitha supozimeve ndërliidhej me angazhimin e tyre në FSK, dhe institucionet e vendit e kanë konsideruar atë si përpjekje për të penguar demokratizimin dhe qasjen gjithëpërfshirëse në shoqërinë Kosovare e cila ishte reflektuar tashmë edhe në FSK.¹⁰ Ndërkohë, nuk ishte e rastësishme pse këto sulme ndodhën në Zubin Potok për vet faktin se shumica e pjesëtarëve serb të FSK-së vijnë nga kjo komunë. Pra, bëhet fjalë për pjesëtarë të këtij komuniteti që vijnë nga fshatrat e kësaj komune të cilat kanë mbetur të izoluara dhe të stigmatizuara politikisht për shkak të “mos-besnikërisë” të tyre ndaj Listës Serbe në Kosovë, parti kjo e cila funksionon si marionetë e “Partisë Progresive Serbe”(SNS), e Presidentit Aleksandër Vuçiq.

Sulme të ngjashme që janë pjesë e fushatës së shantazhit dhe sulmeve ndaj pjesëtarëve serb të FSK-së kanë ndodhur edhe gjatë vitit 2018. Në fillim të këtij viti, Serbët e FSK-së nga Zubin Potoku marrin një kërcënim tjetër. Një mesazh i nënshkruar nga e ashtuquajtura “Armata e Veriut”(Severna Armija) i paralajmëron ata se pjesëmarrja në FSK është tradhti për shtetin e Serbisë dhe institucionet e Kosovës nuk do të kenë mundësinë t’i mbrojnë ata nga pasojat që i presin nëse vazhdojnë të jenë pjesë e FSK-së.¹¹ Duke qenë se këto kërcënime nënshkruhen në emër të këtij grupi fantom, tregon se në Veri të vendit, edhe pas integrimit të serbëve në institucionet vendore, potencialisht edhe më tutje vazhdojnë të veprojnë struktura të ndryshme ilegale të cilat kanë për synim të sfidojnë sundimin e ligjit në vend. Respektivisht, të vënë në pah pamundësinë e shtrirjes së autoritetit të institucioneve vendore të sigurisë në komunat me shumicë serbe, duke ndikuar kështu në krijimin e një imazhi negativ ndaj intitu-

⁹ KOHA.net. (2017). Policia jep detaje për sulmin ndaj pjesëtarëve serbë të FSK-së në Zubin Potok. Gjendet në: <https://www.koha.net/kronike/59752/policia-jep-detaje-per-sulmin-ndaj-pjesetareve-serbe-te-fsk-se-ne-zubin-potok/>

¹⁰ MFSK (2017). Sulmet mbi pjesëtarët e FSK-së të komunitetit serb në Veri akte kriminale dhe të dënueshme. Gjendet në: http://www.mksf-ks.org/?page=1,708,2347#.W3QI_OgzaUm

¹¹ Kallxo.com. (2018). Mesazhe Kërcënuese Ndaj Pjesëtarëve Serbë të FSK-së në Zubin Potok. Gjendet në: <https://kallxo.com/mesazhe-kercenuese-ndaj-pjesetareve-serbe-te-fsk-se-ne-zubin-potok/>

cioneve vendore si të paafta për të shtrirë pushtetin e tyre në gjithë territorin e vendit.

Ndërkohë, është e rëndësishme të analizohet edhe narracioni i përdorur në këtë mesazh kërcënues i cili drejtpërdrejtë bazohej në qasjen refuzuese të Serbisë ndaj FSK-së. Aty FSK paraqitet si kërcënim për shtetin e Serbisë dhe qytetarët Serb të Kosovës. Ajo po ashtu ngrit paralele në mes të FSK-së dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) duke e konsideruar atë si pasuese të kësaj të fundit e cila në fund të viteve të 90-ta luftoi kundër forcave të Ushtrisë Serbe. Kjo linjë qëndrimesh del të jetë e pranishme edhe në nivelet më të larta të udhëheqjes në Serbi, të cilët po vazhdojnë të ndajnë qëndrime dhe qasje të njëjtë me individët apo grupet që po i kryejnë këto akte kriminale në Kosovë. Në Korrik të vitit 2018, presidenti i Serbisë deklaroi se *“Nuk do të dëshironte që një serb të qëllonte mbi një serb tjetër”*, duke iu referuar pjesëtarëve të komunitetit Serb brenda FSK-së.¹² Deklaratat e tilla të qëllimshme ndihmojnë në izolimin e një komuniteti të tërë në Kosovë, duke ngjallur pasiguri përmes shtrembërimit të qëllimeve reale të institucioneve të Kosovës, respektivisht FSK-së. Për të kontribuar në shantazhin dhe përhapjen e frikës, zyrtarët e Serbisë deklaruan se ata që bëhen pjesë e FSK-së duhet të dënohen nga shteti i Serbisë për pjesëmarrje në formacionet e huaja të armatosura.¹³ Pas këtyre deklaratave, pesë pjesëtarë të FSK-së nga komuniteti serb u ndaluan në kufirin me Serbinë për tu marrë në pyetje rreth aktiviteteve të tyre në FSK.¹⁴

Në vitin 2018, presionet e vazhdueshme ndaj pjesëtarëve të FSK-së nga komuniteti serb u bënë të papërballueshme për ta, duke dhënë kështu rezultatet e para. Si rrjedhojë, vetëm në pjesën e parë të këtij viti mbi 60 pjesëtarë serb të FSK-së dorëzuan kërkesat për dorëheqje nga ky institucion. MFSK konsideron se këta pjesëtarë kanë qenë mirë të integruar dhe në nivel detyre dhe dorëheqja e tyre është e lidhur vetëm me shantazhet e vazhdueshme të qarqeve kriminale serbe brenda Kosovës, dhe vetë shtetit të Serbisë.¹⁵ Në anën tjetër, Serbia përkrahë largimin e tyre dhe inkurajon largime të reja, duke e konsideruar këtë veprim si pengesë të drejtpërdrejtë të formimit të Ushtrisë së Kosovës, e cila sipas tyre *“Do të shërbejë ekskluzivisht për të nxitur konflikte”*¹⁶. Përderisa ky grup i pjesëtarëve serb të FSK-së po përdoret për poenë politik nga të dyja anët, ata personalisht kanë hezitur të deklarohen mbi këtë çështje. Njëri prej tyre në kushte anonimiteti u deklarua se ky ishte një vendim kolektiv dhe të qenit jashtë një vendimi të tillë ka qenë gati i pamundur. Sipas tij, ata ishin të detyruar ta braktisin FSK-në për shkak të presionit të vazhdueshëm në kufi me Serbinë dhe kërcënimeve të shpeshta me të cilat ballafaqohen.¹⁷ Përveç të tjerash, largimi i tyre hap rrugën edhe për probleme të karakterit socio-ekonomik. Edhe pse nuk ka informacione mbi nivelin ekonomik të pjesëtarëve të larguar dhe aftësimin e tyre profesional jashtë FSK-së, disa prej tyre kanë ngritur shqetësimet për mungesën e të ardhurave dhe kanë shprehur skepticizëm mbi mundësitë tjera të punësimit.¹⁸

¹² KOHA.net. (2018). Vuçiq për serbët e FSK-së: Nuk do të donim që një serb të gjuante ndaj një serbi. Gjendet në: <https://www.koha.net/arberi/103984/vu-ciq-per-serbet-e-fsk-se-nuk-do-te-donim-qe-nje-serb-te-gjuante-ndaj-nje-serbi/>

¹³ KOHA.net (2018). Gjuriq kërcënon me burgim serbët që shërbejnë në Ushtrinë e Kosovës. Gjendet në: <https://www.koha.net/arberi/89344/gjuriq-ker-cenon-me-burgim-serbet-qe-sherbejne-ne-ushtrine-e-kosoves/>

¹⁴ Gazeta Express (2018). Ministri serb: Ushtarët e FSK-së nuk i arrestuam, vetëm i morëm në pyetje. Gjendet në: <https://www.gazetaexpress.com/la-jme/ministri-serb-usharet-e-fsk-se-nuk-i-arrestuam-vetem-i-morem-ne-pyetje-530978/>

¹⁵ Zeri.info. (2018). Beogradi i detyron serbët të largohen nga FSK-ja. Gjendet në: <http://zeri.info/aktuale/206395/beogradi-i-detyron-serbet-te-largohen-nga-fsk-ja/>

¹⁶ Telegrafi.com. (2018). Gjuriq: Me largimin e serbëve nga FSK-ja, pengojmë formimin e Ushtrisë së Kosovës. Gjendet në: <https://telegrafi.com/gjuriq-largimin-e-serbeve-nga-fsk-ja-pengoje-formimin-e-ushtrise-se-kosoves/>

¹⁷ Telegrafi.com. (2018). Pjesëtarë serb: U detyrova ta braktis FSK-në. Gjendet në: <https://telegrafi.com/pjesetari-serb-fsk-se-u-detyrova-ta-braktis-fsk-ne/>

¹⁸ Po aty.

Pas largimit të 40 pjesëtarëve serb të FSK-së, Policia e Kosovës ndërmori një aksion ku arrestoi 5 shtetas të Kosovës nga nacionaliteti serb të dyshuar për kërcënimin dhe shantazhimin e pjesëtarëve të FSK-së.¹⁹ Menjëherë pas arrestimit të tyre, udhëheqësit e institucioneve të Serbisë u hodhën në mbrojtje të propagandës së vet, duke kërkuar lirimin e menjëhershëm të të arrestuarve. Madje, edhe pse një situatë e tillë shkel legjislacionin e Kosovës dhe do të duhej të zgjidhej brenda Kosovës, Beogradi zyrtar kërcënoi me ndërprerje të bisedimeve Kosovë-Serbi nëse të arrestuarit nuk lirohen.²⁰ Institucionet e Kosovës, njëjtë si pjesëtarët e larguar të FSK-së, të ndodhur para një presioni u dorëzuan ndaj kërkesave të Serbisë duke liruuar pesë të dyshuarit nga ndalimi. Megjithatë, FSK duket të jetë e vendosur në përmbushjen e objektivave të Strategjisë. Në shërbim të këtij qëllimi, FSK planifikon zëvendësimin e të larguarve me pjesëtarë tjerë të komunitetit serb, e sipas tyre ka shumë të interesuar, pavarësisht presioneve të vazhdueshme me të cilat ata ballafaqohen.²¹

Institucionet e Kosovës duhet të kërkojnë përkrahjen e prezencës ndërkombëtare në vend për përgatitjen e një strategjie për integrimin e mëtutjeshëm të komunitetit serb në FSK dhe përmes saj të parashihen edhe masat që duhet të merren për të parandaluar dalje të reja. Në anën tjetër, duke marrë parasysh afrimin e Serbisë me Bashkimin Evropian (BE), kjo e fundit duhet të jetë më e ashpër në qasjen e tyre ndaj këtij problemi. BE duhet të kushtëzojë anëtarësimin e Serbisë me mos-interferimin në institucionet e Kosovës dhe të përkrahë Kosovën në transformimin e FSK-së, qoftë kjo me ndryshime kushtetuese apo jo. Megjithatë, në mungesë të një përkrahjeje të tillë, Qeveria e Kosovës duhet të vazhdojë përpara me procesin e tranzicionit të FSK-së duke marrë parasysh se transformimi i saj realisht nuk has në asnjë pengesë juridike-kushtetuese.²² Ndryshimi i ligjeve që do të hapnin dyert e këtij transformimi është proces legjitim në një shtet demokratik dhe ndikimi në këtë proces mund të konsiderohet si ndërhyrje në vullnetin e qytetarëve të vendit. Qeveria e Kosovës duhet të jetë e qartë në promovimin e këtij procesi pozitiv për vendin, i cili është në shërbim të gjithë qytetarëve të vendit dhe me këtë hap do të rritej niveli i sigurisë në vend dhe rajon.

Me transformimin e FSK-së do të lind edhe nevoja për ngritje të kapaciteteve. Kjo duhet të bëhet në përputhje me kufizimet aktuale buxhetore, pa dëmtuar proceset dhe institucionet tjera dhe me planifikim të detajuar për vitet e ardhshme. Rrjedhimisht, me nevojën për ngritje të kapaciteteve dhe zhvillim të mëtutjeshëm profesional, do të kemi edhe rritje të kërkesave për integrimin e komunitetit serb në këtë institucion. Kësisoj niveli i përfaqësimit të tyre në FSK mund të ketë rritje të lartë në krahasim me atë aktual. Me rritjen e numrit të pjesëtarëve të FSK-së nga komuniteti serb, në mënyrë të pashmangshme do të rritej edhe niveli i besimit karshi këtij institucioni tek ky komunitet. Në këtë aspekt, shoqëria civile mund të ketë rol kyç duke promovuar të mirat që dalin nga procesi i transformimit dhe duke monitoruar procesin për lëshime eventuale. Është me rëndësi që organizatat e shoqërisë civile bashkëpunojnë dhe përkrahin organizatat lokale në komunat me shumicë serbe dhe ti përfshijnë ato në monitorim të procesit dhe ngritje të vetëdijes brenda komunitetit për rëndësinë e përfshirjes së tyre në institucionet e Kosovës.

¹⁹ DW. (2018). Arrestohen e lirohen pesë serb të Kosovës. Gjendet në: <https://www.dw.com/sq/arrestohen-e-lirohen-pese-serbe-të-kosoves/a-44603540>
Po aty.

²¹ Klankosova.tv. (2018). Berisha: Serbët e larguar nga FSK do të zëvendësoheshin me serbë të tjerë. Gjendet në: <http://klankosova.tv/berisha-serbet-e-larguar-nga-fsk-do-te-zevendesoheshin-me-serbe-te-tjere-11fe/>

²² Muharremi. R. (2016) - Forca e Sigurisë së Kosovës Është Ushtri - Argumentet Juridike – Gjendet në: http://www.qkss.org/repository/docs/KSFArmy_AL-B_664971.pdf

Trajtimi me seriozitet i një problemi si ky është i domosdoshëm për funksionimin e mirëfilltë të institucioneve. Ndërhyrja e jashtme në institucionet e Kosovës është një fenomen i rrezikshëm për vendin dhe si i tillë rrezikon procesin e shtet-ndërtimit. Kosova duhet të ngritë këtë çështje në nivel ndërkombëtar dhe të ketë si prioritet zgjidhjen e problemeve të tilla në negociatat Kosovë-Serbi.

REKOMANDIME

- Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me praninë ndërkombëtare në Kosovë, duhet të bëjnë plan për të parandaluar largimin tutje të pjesëtarëve serb të FSK-së;
- Shtetet e Quintit duhet të kushtëzojnë Serbinë në kontekst të integritimit në BE lidhur me veprimtarinë e saj të vazhdueshme në dëm të FSK-së dhe institucioneve tjera;
- Pjesëtarët e larguar tanimë duhet të i nënshtrohen procedurave disiplinore të FSK-së duke pasur parasysh detyrimet kontraktuale që kanë pjesëtarët e FSK-së;
- MFSK të bëjë rekrutimin e ri të pjesëtarëve serb si kundër-masë ndaj veprimeve të Serbisë dhe plotësimin e vendeve;
- Qeveria e Kosovës të fokusohet në një proces të tranzicionit të FSK-së nëpërmjet ndryshimeve të ligjit, tanimë kur janë humbur të gjitha shpresat se procesi i ndryshimeve kushtetuese mund të jetësohet;
- Organizatat e Shoqërisë Civile në koordinim me Institucionet qendrore dhe lokale të organizojnë takime dhe aktivitete të rregullta me komunitetin serb mbi gjendjen e sigurisë në vend;
- Organizatat e Shoqërisë Civile të mbështetin organizatat lokale me bazë në komunitet në komunat me shumicë serbe, dhe në partneritet me to të organizojë trajnime dhe aktivitete të ndryshme me qëllim aftësimin e individëve nga komuniteti serb për punë në institucionet publike.

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës“Pjetër Bogdani”

355.3:35(496.51)(048)

Balaj, Shpat

Tendencat për rrënimin e multietnicitetit :
largimet masive të pjesëtarëve serb të forcës së
sigurisë së Kosovës dhe roli i Serbisë / Shpat Balaj
dhe Taulant Boshnjaku . Prishtinë : Qendra Kosovare
për Studime të Sigurisë, 2018. – 11 f. : ilustr. ; 21 cm.

1. Boshnjaku, Taulant

ISBN 978-9951-679-81-7

www.qkss.org

ISBN 978-9951-679-81-7



9 789951 679817